



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2023:034703

Datë: 24.12.2024

Numri i dokumentit: 06645845

C.nr.16/23

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, **në çështjen e paditësit V. (H.) K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. Klodian Krasniqi, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës I. B. me banim në B., Republika Çeke, për shkak të prishjes së kurorës (shkurorëzim), jashtë shqyrtimi me datën 24.12.2024, mori këtë:**

A K T V E N D I M

Konstatohet se padia për shkurorëzim e paditësit V. (H.) K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, në këtë çështje juridiko - kontestimore, është e **TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësi V. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit përmes të autorizuarit të tij av. K. K. nga Prizreni, ka paraqitur pranë kësaj gjykate me datë 08.02.2023 padinë për shkurorëzim, kundër të paditurës I. B. me banim në B., Republika Çeke.

Në ndërkohë pas përpjekjeve të gjykatës fillimishtë për dorëzimin e padisë bashkë me shkresat si dhe aktvendimit për përgjigje në padi të paditurës I. B. nga Republika Çeke, i autorizuarit i paditësit av. K. K. me parashtrësën e datës 06.12.2024 e ka njoftuar gjykatën se me pelqimin dhe vullnetin e pales paditëse bëjmë tërheqjen e padisë dhe kërkesëpadisë, të dorëzuar pranë kësaj gjykate me datë 08.02.2023.

Anaj pasi që pala vullnetarishtë ka paraqitur padinë dhe vullnetarishtë edhe ka propozuar tërheqjen e saj, kjo gjykatë ka vendosur që padinë e paditësit ta konsideroj si të tërhequr, meqë në bazë të nenit 86 par. 1 të Ligjit për Familjën i Kosovës Nr.2004/32 (LFK), në mënyrë taksative parashihet se: **“Në kontestet për shkurorëzim paditësi mund ta tërheq padinë deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore pa pajtimin e të paditurit, kurse me pajtimin e të paditurit derisa procedura nuk ka përfunduar në formë të prerë”**.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 86 par. 1 të LFK-së, lidhur me nenin 261.1 dhe 261.2 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:034703, 24.12.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kunder këtij Aktvendimi nuk lejohet ankesa (neni 261.4 i LPK-së)